



Pranimi / Deregistruar / Prilazet / Prilazet / Received / Received	23.01	3	viti / god / Year
Organ / Shkronja / Org / Shkronja / Org / Shkronja	SKPMShCK	720/2023	Sasia / Kolorina / Quantity



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1050/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1050/2022 të datës 23.11.2022 e parashtruar nga ankuesja me adresë banimi:

kundër Vendimit me Referencë:ZVVGJ/489/22 të Komisionit për Rishqyrtim të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 27.10.2022, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1050/2022 të datës 23.11.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesi, më datë 23.11.2022 nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.1050/2022 dhe numër protokolli 7350/2022, kundër Vendimit me Referencë:ZVVGJ/489/22 të Komisionit për Rishqyrtim të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 27.10.2022.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se procedura e rekrutimit për pozitën “Administrator në Gjykatën Komerciale” e shpallur me datë 31.05.2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 29 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, në kundërshtim me dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-

114 për Zyrtarët Publik, dispozitat e nenit 4, 6 dhe 7 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase Rregullorja Nr.04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit të Marrëdhënies së Punës për Administrator të Gjykatave mbi bazën e të cilës është zhvilluar procedura e rekrutimit, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjeve të aplikuara në fuqi, ndërsa ankuesja në ankesën e saj kërkon që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të aprovojë ankesën e ankueses si të bazuar, ndërsa lëndën ta kthejë në rivlerësim për shkak të vlerësimit të gabuar të jetëshkrimit (CV) dhe trajtimeve e përvojës së punës, si dhe të testit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.12.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariatit i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 22.12.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7350/2022 të datës 23.11.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mailin e datës 23.11.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Vendimin me Referencë:ZVVGJ/489/22 i Komisionit për Rishqyrtim të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës i datës 27.10.2022; Ankesën e ankueses të datës 21.10.2022 të parashtruar në Komisionin e Rishqyrtim të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Njoftimin e datës 19.10.2022 të Kryetarit të Komisionit të Rishqyrtimit; Njoftimin e Rezultateve përfundimtare i kandidatëve të cilët nuk e kanë kaluar provimin për Administrator-Gjykatën Komerciale Prishtinë i datës 18.10.2022; Listën e kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim i datës 06.10.2022; Shkresën "lista e aplikantëve"; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.12.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 22.12.2022; E-mailin e datës 19.10.2022 dërguar nga

për ankuesen; Vendimin e datës 08.11.2022 për Themelimin e Komisionit të Rekrutimit; Vendimin për shpalljen e konkursit i datës 03.11.2022; Konkursi i shpallur i datës 15.11.2022; E-mailin e datës 27.07.2022 dërguar nga ankuesja për Njësinë e Burimeve Njerëzore; Aplikacionin e ankueses me faqe 1/14 i datës 27.06.2022; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Çertifikatën e shtetësisë e datës 27.06.2022; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykatat Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë e datës 27.06.2022 me numër:1329/2022; Çertifikatën shëndetësore e datës 27.06.2022; Diplomën e datës 22.10.2011 me numër:962/2011; Diplomën e datës 14.06.1997; Çertifikatën e datës 30.06.2009; Vërtetimi e datës 27.06.2022; Akt emërimit e ankueses të datës 07.05.2015; Çertifikatën e periudhës shkurt 2009-mars 2010; Çertifikatën e datës 03.11.2009; Çertifikatën e datës 26.02.2011; Çertifikatën e datës 08.03.2011; Çertifikatën e datës ë.2011; Çertifikatën e datës 06.02.2012; Çertifikatën me shifër protokollit:414/22/09; Çertifikatën e datës 25.12.2010; CV-në e ankueses; Çertifikatën e datës 28.10.2018; Çertifikatën e datës 06.02.2012; E-mailin e datës 10.10.2022 dërguar nga për Zarin postar i datës 22.12.2022; E-mailin e datës 19.01.2023 dërguar nga F.K për Këshillin, Konkursin e shpallur të datës 31.05.2022; Vendimin e datës 01.06.2022 për themelimin e Komisionit për Rekrutim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar

kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ lidhur me ankesën A.nr.1050/2022 të ankueses,

sepse:

Nga shkresat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës, më datë 31.05.2022 ka shpallur konkursin për pozitën *Administrator në Gjykatën Komerciale*, në të cilin konkurs sipas regjistrimit të aplikacioneve të pranuar është dëshmuar se ka aplikuar edhe ankuesja, e cila është përfshirë në listën e shkurtër së bashku me dy kundër kandidatë të tjerë.

Nga kandidatët që ishin përfshirë në listën e ngushtë, vetëm kandidatja e kishte kaluar testin me shkrim sipas njoftimit të datës 06.10.2022 dhe ka marr pjesë në fazën e intervistës me gojë, ndërsa pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka përgatitur renditjen përfundimtare të kandidatëve, ku ankuesja pas testit me shkrim dhe intervistës me gojë ka arritur gjithsejtë 53.6 pikë, kurse më datë 19.10.2022 është publikuar njoftimi me shifër Ref:ZVVGJ/487/2022, në bazë të së cilit rezulton që ankuesja nuk është kandidatja e përzgjedhur, gjegjësisht nuk ka kandidatë fitues pasi që ankuesja ishte e vetmja kandidate që kishte kaluar testin me shkrim dhe kishte marrë pjesë intervistë me gojë. Tutje, ankuesja e pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, me datë 21.10.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Rishqyrtim të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa Komisioni për Rishqyrtim më datë 27.10.2022 ka nxjerr Referencë: ZVVGJ/489/22 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 19.10.2022.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se përmes Vendimit të datës 03.11.2022 me shifër: KGJK.nr.413/2022 të Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është vendosur që të rishpallet konkursi për pozitën *Administrator në Gjykatën Komerciale* pasi që konkursi i datës 31.05.2022 kishte përfunduar pa kandidat të suksesshëm, ndërsa lidhur me konkursin e rishpallur sipas vendimit të datës 03.11.2022 ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill nuk ka paraqitur asnjë pretendim ankimor.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marr parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës në Këshill nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, pasi që konkursi i datës 31.05.2022 për pozitën *Administrator në Gjykatën Komerciale* është anuluar, kështu që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1050/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së